



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



„Kujtesa Net“ Sh.p.k.

Numri i biznesit 70670828

1. K-DOKU NJË;
2. K-DOKU DY,
3. K-FILM NJË;
4. K-FILM DY;
5. K-FILM TRE;
6. K-FILM KATËR;
7. K-FILM PESË; dhe
8. K-REALITY

Personi i autorizuar - Florent PERJUCI

Rr/Pashko Vasa nr 18.

Prishtinë

Ref:1605/493/LIC/ni

VENDIM

për ndërprerjen e licencave të Ofruesve të Shërbimeve së Programore (OSHP-ve): K-DOKU NJË; K-DOKU DY, K-FILM NJË; K-FILM DY; K-FILM TRE; K-FILM KATËR; K-FILM PESË; dhe K-REALITY – (më tej tetë OSHP-të), me seli në Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesit e Shërbimeve Programore (tetë OSHP), janë licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), për transmetimin e TV programeve përmes sistemit të Operatorëve Kabllorë, me seli në Prishtinë.

3. Më datën 16 maj 2016, personi i autorizuar i “Kujtesa Net“ Sh.p.k., përmes një shkrese të dorzuar në KPM, ka njoftuar se vullnetarisht heq dorë nga tetë (8) licenca të OSHP-ve, që ishin të licencuara në kuadër të personit juridik me emër “Kujtesa Net” Sh.p.k.

Arsyetimi


4. Njoftimin për heqje dorë prej tetë licencat në fjalë, nga personi të autorizuar i “Kujtesa Net” Sh.p.k., konsiderohet i mjaftueshëm dhe se Komisioni i KPM-së konstaton se Pala ka vepruar në pajtim me procedurat e KPM-së.
5. Të gjitha obligimet ndaj KPM-së, për tetë licencat e OSHP-ve duhet të kryhen nga personi juridik “Kujtesa Net” Sh.p.k, në kuadër të të cilit janë të licencuara OSHP-të e përmendura në këtë rekomandim.

VENDIM

6. Në takimin e mbajtur më 2 qershor 2016, Komisioni merr vendim për ndërprerjen e tetë (8) licencave të OSHP-ve: K-DOKU NJË; K-DOKU DY, K-FILM NJË; K-FILM DY; K-FILM TRE; K-FILM KATËR; K-FILM PESË; dhe K-REALITY, ndërsa, procedurat për shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, mbetet të zbatohen nga “Kujtesa Net” Sh.p.k. në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Lëshimi i Vendimit

7. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



2 qershor 2016
datë